

I nderuar Z. Matlija,

Ne pergjigje te letres Tuaj me Nr. 122/17 Prot, me lende: "Kerkese per informacion dhe venie ne dispozicion e dokumentacionit", drejtuar Ministrise se Mjedisit, dhe administruar nga Drejtoria e Mbrojtjes dhe Trajtimit te Pyjeve me **Nr. 6133 Prot, date 03.08.2017, ju bejme me dije se:**

•Ne lidhje me pyetjen e pare: **"Sa eshte niveli I shpyllezimit vjetor ne Republiken e Shqiperise per periudhen 2010-2016"?**, - kerkoj te riformuloni pyetjen, pasi termi "shpyllezim", nenkupton zhdukje te fondit pyjor dhe/ose tjetersim te tij. Nese pyetja Juaj nenkupton pikerisht frazimin e mesiperme, atehere une ju percjell dokumentacion dhe shifra te cilat kane te bejne me kalimin e fondit pyjor/kullosor, nga administrimi I Ministrise se Mjedisit ne administrimin e Ministrive te tjera te cilat kryejne aktivitet industrial te tilla si: karera gurore, Miniera, HEC, etj te cilat kryhen me akte te Ministrise se Energjise dhe Industrise; ose resorte turistike, zgjerim I vijes se verdhe urbane, rruge dhe autostarada, etj, te cilat kryhen me akte te pushtetit vendor (Bashkite) ose ministri te tjera si ajo e Turizmit apo Zhvillimit Urban. **Nese pyetja Juaj konsiston ne shtjellimet e mesiperme atehere une ju percjell informacion dhe dokumentacion te sakte nga viti 2013 e deri me tani. Nese Ju nenkuptoni tjetere gje, lutem me sqaroni.**

•Ne lidhje me pyetjen e dyte: "Çfare masash jane marre per ripyllezimin e vendit", une ju raportoje se: nga viti 2014 e deri me tani jane rreth 930 Hektare pyje te ri-pyllezuara ne skema te ndryshme financimi.

a. Nga keto rreth 200 ha pyje jane ripyllezuara si rezultat I investimit nga buxheti I Ministrise se Mjedisit.

b. Rehabilitimi i sipërfaqes pyjore të degraduar filloi menjëherë me shpalljen e "Ditës Kombëtare të Pyllezimit", e cila u finalizua me **Vendimin Nr. 253, datë 29.10.2014**, ku nëpërmjet donacionit të **500 mijë fidanëve pyjorë** dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Arsimit dhe Ministrinë e Brendëshme, u ripyllezuara rreth 200 hektarë me pyje.

c. Ndersa pjesa tjeter prej afo 530 hektarësh, jane detyrim ligjor per pyllezime i subjekteve dhe/ose eneteve te ndryshme qe kryejne aktivitet industrial mbi fondin pyjor/kullosor, dhe qe e drejta e pyllezimit buron nga ligji 10431, nga "Parimi i Zevendesimit".

d. Per vitet 2010 – Shtator 2013, ju bejme me dije se nuk eshte apilikuar asnje projekt ripyllezimi nga ana e ish Ministrise se Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave, ose 0 (zero) hektare ripyllezime.

Nese kerkoni dokumentacion provues ne lidhje me pergjigjen e dyte, lutem te drejtoheni prane Drejtorise se Mbrojtjes dhe Trajtimit te Pyjeve-Ministrira e Mjedisit, me person kontakti Ylli Hoxha, nr. Tel 067 466 3298, pasi e-maili nuk suporton ngarkese te tille materialesh te skanuara bashkalidhur.

Faleminderit per mirekuptimin

Pershendetje,

Duke ju kerkuar ndjese per vonesen e pergjigjes (per arsye te levizjeve jashte vendit), serish me lejoni t'Ju sqaroj si me poshte:

Termi “shpyllezim”, nga definicionet e ligjeve dhe akteve ligjore per pyjet ne Republiken e Shqiperise, k ate beje me siperfaqe qe tjetersohen dhe humbin funksionin e te qenit “pyll”. Per kete qellim, menyra se si Ju e keni riformuluar pyetjen eshte serish e paqarte teknikisht per mua, pasi ne definicionet e akteve ligjore ne perdorim terim “shfrytezim”.

Me lejoni qe t,ju qartesoje ne lidhje me pyetjen qe keni ri-formuluar se:

Pavaresisht se nje pyll pritet (me ose pa lejet perkatese [d.m.th](#) ilegalisht), apo digjet dhe demtohet, ai ekziston serish si fond pyjor, [d.m.th](#) nuk zhduket ashtu sikurse ju citoni ne e-mailin Tuaj.

Nese e keni fjalen ekzaktesisht per shfrytezimet e fondit pyjor (ashtu sikurse eshte edhe definicioni ne aktet ligjore), atehere me lejoni qe t'Ju informoj qe une posedoj informacion, por jo dokumentacion. Dokumentacioni eshte shume voluminoz dhe scanimi apo fotokopjimi I tij per ta vene ne dispozicionin Tuaj eshte absolutisht I pamundur. Ne lidhje me kete, ashtu sikurse ku kam bere me dije edhe ne komunikimin e pare, jeni te mirepritur ne ambjentet e punes per ta para dokumentacionin ne forme “hard copy”.

Faleminderit per mirekuptimin